

AKT THEMELIMI

Emërtimi

1.1 Emërtimi i shoqërisë është "MES TILES" SHPK , me poshtë e quajtur "Shoqëria". Emri tregtar do te jete "Laminam"

Personaliteti juridik

2.1 Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin e saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Selia

3.1 Selia e Shoqërisë është në adresën: Rruga Industriale, Km.1, Objekti 2 katesh, Zk 2679, Nr.pasurie 51/32, Kashar, Tirane.

3.2 Shoqëria mund të hapë dhe mbajë zyra dhe/ose të kryejë aktivitete në vende të tjera, brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë, si dhe të hapë ose mbyllë zyra në vende të ndryshme, përveç selisë së Shoqërisë, brenda territorit shqiptar.

Kohëzgjatja

4.1 Kohëzgjatja e Shoqërisë është për një periudhë kohore të pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Objekti

5.1 Objekti i shoqërisë do të konsistojë në: Tregtimi i materialeve hidraulike, hidrosanitare dhe te ndertimit.

Kapitali i Shoqërisë


6.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është në vlerën 100.000 (njëqindmije) Leke, i perfaqesuar nga 2 (dy) kuota, me vlerë nominale 50.000 (pesedhjetemije) Leke secila. Kapitali i Shoqërisë përbëhet tërësisht nga kontribute në para dhe zotërohet nga Ortaket e Shoqërisë si më poshtë vijon:

- ✓ Z.Endri Mezuraj, mbajtes i kartes se identitetit me nr: I90826055Q, i datelindjes 26.08.1989, lindur ne Vlore, banues ne Tirane, zoterues i nje kuote ne masen 50% te vleres se kapitalit.
 - ✓ Z.Sinan Mezuraj, mbajtes i kartes se identitetit me nr: J80526053O, i datelindjes 26.05.1998, lindur ne Vlore, banues ne Tirane, zoterues i nje kuote ne masen 50% te vleres se kapitalit.
- Kuotat janë të zakonshme dhe lirisht të transferueshme sipas kushteve të parashikuara në ligj dhe në Statut. Përgjegjësia e Ortakeve për humbjet e Shoqërisë shtrihet deri në vlerën e pashlyer të kontributit të nenshkruar.


Asambleja e pergjithshme

7.1 Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë dhe merr vendime kur është mbledhur rregullisht.

Endri Mezuraj



Sinan Mezuraj



7.2 Vendimet e marra nga Asambleja e Përgjithshme, e thirrur dhe e mbledhur rregullisht, në përputhje me ligjin dhe me këtë Statut janë të detyrueshme për të gjithë ortakët përfshirë ata që mungojnë.

7.3 Asambleja e Përgjithshme mbledhet në rastet e parashikuara nga ky Statut, nga ligji në fuqi "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", ligje të tjera dhe sa herë është e nevojshme për mbrojtjen e interesave të Shoqërisë.

7.4 Asambleja e Përgjithshme mbahet në selinë e Shoqërisë ose në çdo vend tjetër të shënuar në njoftimin për mbledhje. Njoftimi për mbledhje i dërgohet me shkrim të gjithë ortakëve jo më vonë se 7 (shtatë) ditë përpara datës së mbledhjes. Njoftimi duhet të përmbajë vendin, datën, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes.

7.5 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret nga administratorët. Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme mund të kërkohet edhe nga ortaku ose ortakët që përfaqësojnë jo më pak se 5% të totalit të votave në Asamblesë të Përgjithshme.

Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme

8.1 Asambleja e Përgjithshme vendos për:

- përcaktimin e politikave tregtare;
- ndryshimin e Statutit;
- emërimin dhe shkarkimin e Administratorit/ëve dhe caktimin e shpërblimit të tij/tyre;
- emërimin dhe shkarkimin e likuidatorit/ëve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar dhe shpërblimin e tyre;
- mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe raportet e ecurisë së veprimtarisë;
- miratimin e zmadhimit dhe zvogëlimit të kapitalit të Shoqërisë;
- pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- përfaqësimin e Shoqërisë në gjykatë dhe në procedime të tjera kundër administratorit/ëve;
- shpërndarjen e fitimeve;
- riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë;
- miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të Asamblesë;
- çështje tjetër të caktuar nga ligji ose nga ky Statut.

Administratori

9.1 Shoqëria administrohet nga një Administrator, i cili është person fizik, i zgjedhur brenda ose jashtë bashkësisë së ortakëve, dhe emërohet nga Asambleja e Përgjithshme për një periudhë 5 (pesë) vjeçare, me të drejtë riemërimi.


9.2 Administratori shkarkohet nga detyra, në çdo kohë, me vendim të zakonshëm të Asamblesë së Përgjithshme sipas ligjit.

9.3 Administrator i parë i Shoqërisë caktohet z. Sinan Mezuraj.

Nënshkruar, sot më datë 29.07.2024

ORTAKET

Endri Mezuraj



Sinan Mezuraj

